

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-23-11243-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Intervenimet Emergjente Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	DESHISHKU GB SH.P.K.
NUI	810007460
Adresa	Radovan Zogoviq, 101/2/8
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044/665544
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Gentian Deshishk
Adresa elektronike	info@deshishkugb-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	20.11.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Intervenimet Emergjente Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025)

Njoftimit për kontratë: 18.10.2023

Vlera e parashikuar: 30.000,00 Euro

Data e dorzimit të ofertave: 26.10.2023

Njoftimi mbi vendimi e AK: 03.11.2023

Kërkesë për rishqyrtim: 08.11.2023

Përgjigje e kërkesës për rishqyrtim: 09.11.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë: 08.11.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, kërkesën në fjalë e gjeni të bashkangjitur.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues: Komuna Glllogoc, me datë: 03.11.2023, ka shpërblyer me kontratë OE: Luigj Kastrati B.I., për tending me titull: Intervenimet Emergjente / Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025); Me numër të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1.

Me datë: 08.11.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të AK, por të njëjtit e kanë cilësuar të pa bazë kërkesën tonë, në përgjigjjen e kërkesës për rishqyrtim të datës: 09.11.2023 i kanë shtuar dhe ndryshuar arsyjet e eliminimit nga venimi i datës: 03.11.2023.

Arsyja e eliminimit nga AK, në vendimin e datës: 03.11.2023, kanë qenë: I mungojnë referenca dhe kontratat e natyrës së ngjajshme.

Ne dosje të tenderit të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar: Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e fundit nga dita e Publikimit të Njoftimit për Kontratë min. 30,000.00 €.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar **kontrata identike** por ka kërkuar **kontrata të ngjajshme**.

Ne vijim ju paraqesim kontratat e ngjajshme dhe shume të peraferta me aktivitetin e prokurimit në fjalë:

1.

Punëdhësi: Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A; Titulli i kontratës: Mbulimi i deponisë; Vlera e kontratës: 17.152,00 Euro (Në këtë aktivitet

te prokurimit kemi bere grumbullimin dhe transportin e mbeturinave te ndryshme si dhe mbulimin e tyre si mbas kerkesave te shpejta te AK, po ashtu kemi bere transportin e kafsheve, gruposjen dhe mbulimin e tyre mbrenda deponise se licencuar).

2.

Punedhenesi: Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A; Titulli i kontrates: Mbulimi i deponise; Vlera e kontrates: 43.200,00 Euro (Ne kete aktivitet te prokurimit kemi bere grumbullimin dhe transportin e mbeturinave te ndryshme si dhe mbulimin e tyre si mbas kerkesave te shpejta te AK, po ashtu kemi bere transportin e kafsheve, gruposjen dhe mbulimin e tyre mbrenda deponise se licencuar).

3.

Punedhenesi: Komuna Skenderaj; Titulli i kontrates: Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve nëpër Bshkësi lokale Runik, Klinë, Likoc, Rezallë dhe Turiçec në Komunën e Skenderajit; Vlera e kontrates: 185.000,00 Euro.

Ndërsa në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK i ka ndryshuar dhe shtuar arsyjet e eliminimit, ne vijim ju paraqesim arsyjet e eliminimit nga përgjigja ne fjalë:

1. Ju mungojnë kontratat e natyrës së ngjajshme sipas DT dhe Njoftimit për kontratë, përkatësisht natyrës lidhur me dizenfektim.

2. Dhe ju mungon te paisjet - Pompa për dizenfektim.

Ne konsiderom me bindje të plotë që kemi kontrata të ngjajshme, të cilat i kemi paraqitur me lartë, në këtë mënyrë ju kemi paraqit edhe AK, të cilat nuk i kane marrë për bazë. Ne kemi paraqitur të gjitha paisjet teknike që janë kërkuar ne DT, po ashtu kemi paraqit ne listë edhe makinën për sperkatje - dizenfektim e cila nuk është kërkuar në DT, por dëshmit mbi paisjen na janë ngatrruar dhe si të tilla na kanë mbetur pa i dorzuar, por AK ka pasur mundesi duke ju referuar Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, të kërkojë dëshmi mbi paisjen. Por të njëjtit në automatizem na kanë eliminuar pa kërkuar sqarime shtesë.

Ne konsiderojm që jemi anashkaluar padrejtësisht nga AK, andaj kerkojm nga ana juaj si ORGAN SHQYRTUES I PROKURIMIT të veproni në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nga pamundësa të ekzekutojm kontratën kemi hubur profitn e parapara ne vlerë 20%, të vlerës se kontrates.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*